

VENDIM
Nr. 191, datë 31.3.2021

PËR PJESËMARRJEN E PERSONELIT TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË OPERACIONIN E NATO-s NË IRAK (NMI)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të nenit 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “ç”, të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dërgimin me mision të 1 (një) ushtaraku të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, në operacionin e NATO-s në Irak (NMI), në Bagdad, Irak.

2. Misioni i ushtarakut është këshillimi për stafin e Universitetit të Mbrojtjes së Irakut, me qëllim zhvillimin dhe përmirësimin e moduleve të programeve të arsimit dhe detajimin e organizimit të kurseve, duke përfshirë strukturën dhe procedurat, si dhe këshillimi për praktikantët me të mira për stafin kryesor të Universitetit të Mbrojtjes.

3. Kohëzgjatja e këtij misioni është deri në 5 (pesë) vjet, afat i cili fillon të llogaritet nga data e dërgimit të përfaqësuesit të parë në mision. Periudha e qëndrimit në mision do të jetë me sistem rotacioni në çdo 1 (një) vit, periudhë së cilës i shtohen edhe ditët e qëndrimit për ndërrimin me kontingjentin e radhës (marrjen dhe dorëzimin e detyrës, vonesa të transportit strategjik).

4. Ministria e Mbrojtjes, për personelin pjesëmarrës në këtë operacion, të përballojë shpenzimet për:

a) dieta për ditët e qëndrimit, në masën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në ditë, përveç pagës mujore;

b) sigurimin e jetës;

c) siguracion shëndetësor jashtë zonës së operacionit;

ç) mbështetje shëndetësore;

d) shpenzime për telefon, internet dhe shërbime postare;

dh) energji elektrike, ujë dhe ujë i pijshëm;

e) transport;

ë) aktivitete social-kulturore në rastet e festave kombëtare, gjatë kohës së kryerjes së misionit;

f) çdo shpenzim tjetër për mbarëvajtjen e kryerjes së misionit.

5. Transporti i personelit, që do të shërbejë në Irak, ndërsa nis, ndryshon dhe përfundon detyrën, për t'u kthyer në Shqipëri, mbështetja shëndetësore, akomodimi, ushqimi, lavanderia, transporti i personelit të shkëputur nga misioni për në atdhe në rast vdekjeje, sëmundjeje ose thyerjeje disipline të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes, me përjashtim të rasteve kur do të arrihet nënshkrimi i marrëveshjeve dy ose shumëpalëshe, ku pala tjetër merr përsipër të përballojë këto shpenzime.

6. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e miratuara në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.

7. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe